



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM

Nr. 585, datë 16.12.2021

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, etj; Akuza : Nenet 284/2, 283/2, 278/2, 278/3, 287, 248 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Merita Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 78/1-22 e 278/1 dhe 84 i Kodit Penal.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}; I Paditur: {...} Tiranë, {...} Sarandë; Objekti: Anullimin (shfuqizimin) e akteve administrative për vendimet për dënimin me gjobë nr. 15 datë 09.03.2016 dhe nr. 23 datë 18.03.2016 të {...}, etj.”

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Sigurim padie.
- II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR